



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0721

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Isa Hasani Anetar dhe Batisha Ibrahimimi Anetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) General Holding L.L.C. : Mirusha Company SH.P.K. & Sinani Ing SH.P.K. kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit të “Komuna e Klinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i urës automobilistike nga betoni në fshatin Dugajeve me numër të prokurimit: 634-25-5200-5-2-1, me 06/10/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e pjesërisht e bazuar ankesa e OE General Holding L.L.C. : Mirusha Company SH.P.K. & Sinani Ing SH.P.K. me nr. 2025/0721, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i urës automobilistike nga betoni në fshatin Dugajeve me numër të prokurimit 634-25-5200-5-2-1, ndërsa (AK) - Komuna e Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktuesi mbetet në fuqi vendimi i AK

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues ndërsa aktiviteti i prokurimit si në pikën 1 të dispozitivit

3. Lejohet kthimi i tarifave të ankesës në shumen e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtoj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 11.06.2025 Komuna e Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i urës automobilistike nga betoni ne fshatin Dugajeve me numër të prokurimit 634-25-5200-5-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 495,000.00 €.

Me 21.07.2025 OE General Holding L.L.C. : Mirusha Company SH.P.K. & Sinani Ing SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

OSHP ka pranuar ankesën nga OE General Holding L.L.C. : Mirusha Company SH.P.K. & Sinani Ing SH.P.K. me nr. 0721/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i urës automobilistike nga betoni ne fshatin Dugajeve me numër të prokurimit 634-25-5200-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues General Holding L.L.C. : Mirusha Company SH.P.K. & Sinani Ing SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi nr 1. Ku neve si O.E (Grup i O.E0) nuk na ka shperblzer me kontrat duke propoyuar G.E.E Benita shpk nga Klina dhe Ledioni group Shpk nga Semetishti Suharek te cilet nuk kane qene te pergjegjeshem ne aspektin administrativ. Grupi i themeluar ne baz te Formularit standard per krijim te grupit ka Nominuar Lider te grupit O.E Ledioni Group Shpk nga Semetishti Suharek derisa ne Procesverbal del se lider eshte Benita Companz nga Klina. Bazuar ne kete tani nese vije momenti per Kontrat sistemi e njej Lider Beniten dhe ndryshimi ne vijim do te kete pasoja juridike meq Neneshkrimin e kontrates sistemi do te kerkoj kete .

Pretendimi nr 2. A.K. Komuna Kline nuk ka respektuar Nenin 59 te Ligjit te PP ku ne kontekst te kesaj edhe shekeljen e nenit 69 –Aftesia teknike profesionale .Grupimi i O.E i propozuar per kontrate nuk ka plotesuar kerkesen e A.K:nga dosja e tenderit **Kerkesa Iso standartet e kerkuara ISO 9001 2015 Për sistemin e menaxhimit te cilesisë; ISO 14001 2015 Për sistemin e menaxhimit te mjedisit; ISO 39001 2012 Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor ISO 45001 2018 Për sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune;** Licencat jane te prezentuara vetem nga Anetari i grupit Benita Company e jo nga anetari tjeter Anetari Ledioni Group Shpk nuk ka te prezentuara keto Licenca, Neni 71 i LPP Grupi i O..Ekonomik Neni 71 4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. **Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68**

dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. 26.6 Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përputhshmërinë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Në rast të kontratave për furnizime, punë, shërbime, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, **secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.** Pika 26.6 e Rregullores PP 02-2024 Kerkon qe secili anetar i grupit duhet te deshmoj peer permbushjente ketyre standardeve .

Pretendimi 3 Nuk ka vleresuar drejt andaj pretendimet ona qe Grupi O.E Benita Company nga Klina dhe Ledioni Group nga Suhareka nuk jane te pergjegjeshem shikuar shkeljet e shfletuara me lart , ku shkeljet jane substanciale dhe A.K. nuk eshte treguar profesional ne vleresimin e ketij tenderi bazuar ne Kerkesat e tyre dhe deshmive qe kane pranuar nga ky grupim i O.E.

Perfundim Kerkojm nga A.K. Komuna Klines te Anuloj Vendimin e dates 17.07.2025 dhe procesi te kethehet ne Ri Vleresim ku do te behet vleresim i drejt dhe Oferta jone te konsiderohet per shperblim me kontrat. Vazhdim i pretendimeve pas Vendimit te A/K .Kline A.K. Komuna e Klines ne Vendimin kunder pretendimeve ne Kerkesen per Ri shqyrtim me date 24.07.2025 jo qe ka pranuar faktet dhe deshmit tona por ky autoritet thellohet me thell ne shkeljet ne veprimet ne shkelje te LPP perkatesisht Rregullores se PP nr. 02-2024. A.K. ne arsytimet e tyre qe peshon gabime te vogla .Lind pyty me Cfar kriteri A.K . peshon gabimet . Aq me teper te gjitha arsytimet i bazon ne Rregulloren e PP 01-2022 e cila rregullore eshte e terhjekur nga veprimi aktual .Derisa per Kamionin qe eshte i pa regjistruar (I Cregjistruar) A.K. thot se nuk eshte kerkuar te jete i regjistruar Absurd Lind pytyja ky automjet a mund te dal ne Carkullim ne trafik apo tjetra nje automjet qe nuk eshte i regjistruar dhe mund te regjistrohet vetem kur i nevojitet kjo eshte jo ligjore e aq me teper nje makineri qe duhet te veproj duke qen teknikisht ne rregull e kur ky kamion nuk eshte i regjistruar edhe nuk mund te jete teknikisht i gateshem per pune .Fakt tjeter eshte edhe Krani i marrur nga Nje Kompani per te dy pjesemarresit ne tender . Per Ledioni nga Suhareka dhe O.E. General Holding nga Klina .Mareveshjet shihen se njera eshte jo e neneshkruar nga Personi zyrtar ,Shihen neneshkrimet .A.K. arsytohet se A.K. nuk ka kometenc me i shiku dokumentet .Mendoj se kete te drejt e ka meq nje dokument ‘ jo i vertet ‘ A.K. ka te drejten me kerky sqarim nga O.E . e ne raste kur veretethoet se nje dokument eshte jo i vertet ateher e drejta per ate O.E qe prezenton dokumente te falsifikuara dihet Cfar duhet te veproj.Per keto dhe te tjera shkelje Kerkoj nga OSHP qe te shikoj Tenderin – Dokuentacionin e Propozuar per kontrates, Pretendimet tona , Vendimin e A.K. komuna e Klines kunder Kerkeses per ri shqyrtim dhe faktet qe jane ne ofert ky shihen shkeljet e bazuara qe kemi shprehur ne Kerkesen tone dhe Ankesa jone te Miratohet e BAZUAR dhe procedura te kethehet ne Ri Vleresim e ndaj A.K. Vleresoj drejt bazuar ne LPP .

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 06/08/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0721/2025, ndërsa me datë 18/08/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0721 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE General Holding L.L.C. : Mirusha Company SH.P.K. & Sinani Ing SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0721 ka vlerësuar si në vijim: Aktiviteti i prokurimit me titull: “Ndertimi i Ures automobilistike nga betoni ne fashtin Dugajeve” me nr. të prokurimit: "634-25-5200-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm. Ankesa është e parashtruar kundër Vendimit B58 të Autoritetit Kontraktues mbi rekomandimin e grupit të operatorëve ekonomik. OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së duke pretenduar se AK gjatë vlerësimit të ofertave shkelë nenet: 7,59,69,71 i Ligjit për prokurim publik si dhe pika 26.6 Krijimi i grupit të OE-Rregullorja e PP nr.02/2024.

Pretendimi i OE ankues: Ku neve si O.E (Grup i O.E0) nuk na ka shpërblyer me kontrate duke propozuar G.E.E Benita shpk nga Klina dhe Ledioni group Shpk nga Suhareka te cilet nuk kane qene te pergjegjeshem ne aspektin administrativ. Grupi i themeluar ne baz te Formularit standard per krijim te grupit ka Nominuar Lider te grupit O.E Ledioni Group Shpk nga Suhareka derisa ne Procesverbal del se lider eshte Benita Company nga Klina. Bazuar ne kete tani nese vije momenti per Kontrat sistemi e njej Lider Beniten dhe ndryshimi ne vijim do te kete pasoja juridike meqe Neneshkrimin e kontrates sistemi do te kerkoj kete .

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues: Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në E-Prokurim shpjegon se, në ofertën e Grupit OE gjendet Marrëveshja mbi themelimin e konzorciumit, në të cilën deklaratë të anëtarëve deklarohet Lider OE Ledioni SHPK, dhe të gjitha dokumentet janë të nënshkruara nga lideri i përcaktuar sipas deklaratave Ledioni SHPK. Mirëpo teknikisht gjatë regjistrimit dhe dorëzimit të ofertës, i njëjti ka shtuar në sistem të E-prokurimit fillimisht anëtarin e konzorciumit e pastaj liderin, e cila shfaqet pastaj në Procesverbal të hapjes si emërtim Grupi OE Benita Company SHPK Ledioni SHPK! Në rastin konkret duke qenë se deklaratat, nënshkrimet dhe vulat deklarojnë se Lider është Ledioni SHPK, dhe meqenëse në LPP e as në manual për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës nuk përcaktohet se patjetër në sistem duhet të renditen sipas deklaratës, atëherë ky gabim teknik në sistem konsiderohet devijim i vogël konform nenit 59.4 të LPP-së me qëllim të respektimit të nenit 6 të LPP-së. Pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i OE ankues: A.K. Komuna Kline nuk ka respektuar Nenin 59 te Ligjit te PP ku ne kontekst te kesaj edhe shkeljen e nenit 69 –Aftësia teknike profesionale .Grupimi i O.E i propozuar për kontrate nuk ka plotësuar kërkesën e A.K nga dosja e tenderit Kerkesa Iso standartet e kerkuara ISO 9001 2015 Për sisitemin e menaxhimit te cilesisë; ISO 14001 2015 Për systemin e menaxhimit te mjedisit; ISO 39001 2012 Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor ISO 45001 2018 Për systemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune;Licencat jane te prezentuara vetem nga Anetari i grupit Benita Company e jo nga anetari tjeter Anetari Ledioni Group Shpk nuk ka te prezentuara keto Licenca,

Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues: Pretendimi i OE ankues lidhur me certifikatat e ISO, ekspertja shqyrtuese bazuar në Rregulloren e konsoliduar data 11.11.2024 nr.002/2024 neni 26.5, meqenëse AK këto kërkesa i ka paraparë tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale neni 66.2, atëherë si e tillë plotësohet kërkesa si grup në tersi. Gjithashtu edhe konform neni 26 të Rregullores së përditësuar plotësim/ndryshim 11.11.2024 nr.002/2024, pjesa që ka qenë duhet te ofrohet nga secili antarë, me plotësim ndryshim është heq dhe nuk përcakton që secili duhet të plotësoj kërkesën, citat 26.6:26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Në rast të kontratave për furnizime, punë, shërbime, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare. Citat 26.5 Rregullorja e PP versioni i konsoliduar: Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Citat neni 66.2 i LPP_se:2. Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaratën nën betim se një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Pretendimi i OE ankues: Nuk ka vlerësuar drejt andaj pretendimet tona qe Grupi O.E Benita Company nga Klina dhe Ledioni Group nga Suhareka nuk jane te pergjegjeshem shikuar shkeljet e shfletuara me lart , ku shkeljet jane substanciale dhe A.K. nuk eshte treguar profesional ne vleresimin e ketij tenderi bazuar ne Kerkesat e tyre dhe deshmime qe kane pranuar nga ky grupim i O.E.A.K. Komuna e Klina ne Vendimin kunder pretendimeve ne Kerkesen per Ri shqyrtim me date 24.07.2025 jo qe ka pranuar faktet dhe deshmit tona por ky autoritet thellohet me thell ne shkeljet ne veprimet ne shkelje te LPP perkatesisht Rregullores se PP nr. 02-2024.A.K. ne arsytimet e tyre qe peshon gabime te vogla .Lind pyty me Cfar kriteri A.K . peshon gabimet . Aq me teper te gjitha arsytimet i bazon ne Rregulloren e PP 01-2022 e cila rregullore eshte e terhejkur nga veprimi aktual .

Derisa per Kamionin qe eshte i pa regjistruar (I Cregjistruar) A.K. thot se nuk eshte kerkuar te jete i regjistruar Absurd Lind pytyja ky automjet a mund te dal ne Carkullim ne trafik apo tjetra nje automjet qe nuk eshte i regjistruar dhe mund te regjistrohet vetem kur i nevojitet kjo eshte jo

ligjore e aq me teper nje makineri qe duhet te veproj duke qen teknikisht ne rregull e kur ky kamion nuk eshte i regjistruar edhe nuk mund te jete teknikisht i qasshem per pune .Fakt tjeter eshte edhe Krani i marrur nga Nje Kompani per te dy pjesemarresit ne tender . Per Ledioni nga Suhareka dhe O.E. General Holding nga Klina .

Mareveshjet shihen se njera eshte jo e neneshkruar nga Personi zyrtar ,Shihen neneshkrimet .A.K. arsytohet se A.K. nuk ka kometenc me i shiku dokumentet .Mendoj se kete te drejt e ka meqe nje dokument ' jo i vertet ' A.K. ka te drejten me kerky sqarim nga O.E . e ne raste kur veretethoet se nje dokument eshte jo i vertet ateher e drejta per ate O.E qe prezenton dokumente te falsifikuara dihet Cfar duhet te veproj.Përgjigje në pretendimin ankimor të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sa i përket pajisjeve, sqaron se, Grupi i OE të rekomanduar në ofertë kanë paraqitur dy kamion me kran me marrëveshje me qira, njëri kamion ka peshën 8,460 si peshë ngarkuese, ndërsa në DT është kërkuar nga 9 deri 10 Ton, mirëpo i njëjti posedon shtesë edhe kamionin me kran me marrëveshje me qira i cili për momentin është i çregjistruar, të cilët kanë nënshkruar një deklaratë, se nëse fitojnë tenderin do ta regjistrojnë, andaj si e tillë meqenëse AK nuk ka kërkuar që të jenë me validitet pajisjet, si e tillë merret e mirëqenë.

Kërkesa në DT:Kërkesa- Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje të marrjes me qira) të mjeteve, librezat e qarkullimit, ndersa per ato mjete që nuk kanë librezat të qarkullimit. d Deklaratat unike doganore apo fatura. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.Tutje, lidhur me Marrëveshjen për Kran, i cili pretendon se dyshohet nuk është nënshkruar nga i njëjti person, ekspertja shqyrtuese konsideron se mbetet në diskrecion të AK-së konform nenit 52.7 të LPP-së që të kontrolloj dokumentet e dyshuara.Si përfundim, bazuar në sqarimet nëpër pretendimet ankimore të OE ankues, ekspertja shqyrtuese rekomandon që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar, mirëpo me qëllim që të respektohet neni 6 i LPP-së dhe kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm, atëherë propozohet të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së

tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i urës automobilistike nga betoni ne fshatin Dugajeve me numër të prokurimit 634-25-5200-5-2-1. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik General Holding L.L.C. : Mirusha Company SH.P.K. & Sinani Ing SH.P.K., te aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e shih si pjesërisht të bazuara, si dhe AK i mbetet ne fuqi vendimi i tyre.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Paneli sqaron se përveç nenit 1,6,7,27,28 dhe 59 të Ligjit për Prokurim Publik, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë ofertuesit janë të vetëdijshëm për procesin e aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit në përputhje me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Kanë përvojë të mjaftueshme në këtë fushë dhe janë pjesëmarrës të vazhdueshëm nëpër tendere që publikohen në Republikën e Kosovës, duke kontribuar në një aplikim të ndershëm dhe të drejtë për të gjithë.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit në mungesë të provave jo kontestuese nuk ofron bazë ligjore për ri-vlerësim eventual të tij dhe nuk është në harmoni me nenin 1 dhe nenit 7 të LPP. Në fakt synimi i këtij aktiviteti të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP, sipas të cilit në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundur, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform legjislacionit në fuqi dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, përfshirë dhe operatorët ekonomik të cilët janë provuar nga qasja në dokumente.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - General Holding L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: